



INSTITUTI KAF ©IKAF

2019

Syllabus

Kontabilist i Certifikuar

Zhvillo karrieren me iKAF

Kontabilist i Certifikuar

Kualifikimi “Kontabilist i Certifikuar” është gjithçka që nevojitet për të qenë kontabilist profesionist. Ky kualifikim u jep rëndësi të veçantë aftësive të raportimit financiar të cilat duhet të zhvillohen në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Kontabilistët e Certifikuar po ashtu do t'i mësojnë principet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes, metodat e auditimit dhe standardet, e po ashtu do të fitojnë njohuri të konsiderueshme në lëmin e planifikimit të biznesit, vendimmarrjes dhe menaxhimit të performancës.



Skema e Moduleve të Nivelit Kontabilisti i Certifikuar

MODULI KC-F4 Ligji i Korporatave dhe Biznesit	<ul style="list-style-type: none">▪ Sistemi juridik i vendit▪ Marrëdhëniet e detyrimeve▪ Marrëdhëniet e punës▪ Ligjet për shoqëritë tregtare▪ Kapitali dhe shoqëritë▪ Menaxhimi i Kompanive▪ Falimentimi▪ Raportimi financiar▪ Shkeljet ligjore penale
MODULI KC-F5 Menaxhimi i Performances	<ul style="list-style-type: none">▪ Kostot speciale dhe teknikat e menaxhimit të kontabilitetit▪ Teknikat e vendimmarrjes▪ Buxheti▪ Kostoja standarde dhe analiza e mospërputhjeve▪ Sistemet e menaxhimit të performancës, matjes dhe kontrollit
MODULI KC-F7 Raportimi Financiar	<ul style="list-style-type: none">▪ Korniza konceptuale për raportim financiar▪ Korniza rregullative për raportim financiar▪ Pasqyrat Financiare▪ Kombinimet biznesore▪ Analizimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare
MODULI KC-F8 Auditimi dhe Siguridhënia	<ul style="list-style-type: none">▪ Korniza e auditimit dhe rregullorja▪ Auditimi i brendshëm▪ Planifikimi dhe vlerësimi i riskut▪ Kontrolli i brendshëm▪ Të dhënat e auditimit▪ Rishikimi▪ Raportimi
MODULI KC-F9 Menaxhimi Financiar	<ul style="list-style-type: none">▪ Funksioni i menaxhimit financiar▪ Menaxhimi i kapitalit punues▪ Vlerësimi i investimeve▪ Financat e biznesit▪ Kostoja e kapitalit▪ Menaxhimi i rrezikut▪ Vlerësimet e biznesit

Moduli

KC-F4 Ligji i Korporatave dhe Biznesit

15 Kredi


Objektivat

Objektiv kryesor është zhvillimi i njohurive dhe kuptimi i parimeve dhe koncepteve të përgjithshme të kornizës ligjore dhe fushave të caktuara në lidhje me biznesin, duke njohur nevojën për të kërkuar këshilla të mëtejme profesionale. Objektivat e detajuara:

- ❖ Identifikimi i elementeve thelbësore të sistemit ligjor, duke përfshirë edhe burimet kryesore të ligjit;
- ❖ Njohja dhe zbatimi i rregullave të duhura ligjore në marrëdhënie me detyrimet;
- ❖ Shpjegimi dhe zbatimi i ligjit në lidhje me marrëdhëniet e punës;
- ❖ Njohja e mënyrës së themelimit të shoqërive tregtare dhe ligjet për shoqëritë tregtare;
- ❖ Njohja dhe krahasimi i llojeve të kapitalit dhe themelimin e kompanive
- ❖ Njohja dhe shpjegimi se si menaxhohen dhe administrohen kompanitë;
- ❖ Njohja e implikimeve ligjore në lidhje me paftësinë paguese të kompanive
- ❖ Njohja e rregullave për klasifikimin e shoqërive tregtare dhe raportimin financiar;
- ❖ Shkeljet ligjore penale të personave juridik dhe zyrtarë;

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Sistemi juridik i vendit,
- ❖ Marrëdhëniet e detyrimeve,
- ❖ Marrëdhëniet e punës,
- ❖ Ligjet për shoqëritë tregtare,
- ❖ Kapitali dhe shoqëritë,
- ❖ Menaxhimi i Kompanive,
- ❖ Falimentimi,
- ❖ Raportimi financiar,
- ❖ Shkeljet ligjore penale.



Karakteristikat e Ligjëratës Trajnuese:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Ligji i korporatave dhe biznesit F4 - gjatë ligjëratës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të teste, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërate, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

KC-F5 Menaxhimi i Performancës

15 Kredi

Objektivat

Objektiv kryesor është zhvillimi i njohurive dhe aftësive në aplikimin e teknikave të menaxhimit të kontabilitetit për të marrë informacione të shumta dhe cilësore për planifikimin, vendimmarrjen, vlerësim dhe kontrollim të performancës. Objektivat tjera:

- ❖ Shpjegimi dhe aplikimi i teknikave të kontabilitetit të kostos;
- ❖ Zgjidhja dhe zbatimi adekuat i teknikave të vendimmarrjes, për të lehtësuar vendimet e biznesit dhe për të promovuar përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve të pakta të biznesit, duke vlerësuar rreziqet dhe pasiguritë në biznes dhe kontrollimin e atyre rreziqeve;
- ❖ Identifikimi dhe aplikimi i teknikave dhe metodave të duhura për planifikim dhe kontrollim të buxhetimit;
- ❖ Përdorimi i sistemeve standarde të kostos për të matur dhe kontrolluar performancën e biznesit dhe për të identifikuar masat korrigjuese;
- ❖ Identifikimi dhe diskutimi i sistemeve të menaxhimit të performancës të informacionit dhe vlerësimit të performancës së një biznesi si nga pikapamja financiare dhe jo-financiare, duke vlerësuar problemet e kontrollit të bizneseve të ndara dhe rëndësinë e llogaritjes për aspektet e jashtme.

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Kostot speciale dhe teknikat e menaxhimit të kontabilitetit,
- ❖ Teknikat e vendimmarrjes,
- ❖ Buxheti,
- ❖ Kostoja standarde dhe analiza e mospërputhjeve,
- ❖ Sistemet e menaxhimit të performancës, matjes dhe kontrollit.



Karakteristikat e Ligjërës Trajnues:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Menaxhimi i Performancës F5 - gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërë, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

KC-F7 Raportimi Financiar

15 Kredi

Objektivat

Zhvillimi i njohurive dhe aftësimi në kuptimin dhe përdorimin e standardeve të kontabilitetit dhe kornizës teorike në përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike, duke përfshirë grupet dhe mënyrën e analizimit dhe interpretimit të pasqyrave financiare. Objektivat e detajuara:

- ❖ Diskutimi dhe aplikimi i kornizës konceptuale për raportim financiar
- ❖ Diskutimi i kornizës rregullative për raportim financiare
- ❖ Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit
- ❖ Llogaritja e kombinimeve biznesore në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit
- ❖ Analiza dhe interpretimi i pasqyrave financiare

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Korniza konceptuale për raportim financiar
- ❖ Korniza rregullative për raportim financiar
- ❖ Pasqyrat Financiare
- ❖ Kombinimet biznesore
- ❖ Analizimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare



Karakteristikat e Ligjërës Trajnuesë:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Raportimi Financiar F7 - gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërëse, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

KC-F8 Auditimi dhe Siguridhënia

15 Kredi

Objektivat

Objektiv kryesor është zhvillimi i njohurive dhe kuptimi i procesit të zbatimit të angazhimit të sigurisë dhe aplikimit të saj në kontekstin e kornizës së rregullores profesionale. Objektivat e detajuara:

- ❖ Sqarimi i konceptit të auditimit dhe siguri-dhënies, si dhe funksionet e auditimit, qeverisjes korporative, përfshirë etiken dhe administrimin profesional
- ❖ Demonstroni se si auditori merr dhe pranon angazhimet e auditimit, vlerëson rrezikun e materialit me gabime (qofshin ato nga mashtrimet apo parregullsitë tjera) dhe planifikon auditimin e pasqyrave financiare
- ❖ Përshkrimi dhe vlerësimi i kontrolleve të brendshme, teknikat dhe testet e auditimit, duke përfshirë IT sistemet për të identifikuar dhe komunikuar rreziqet e kontrollit dhe potencialin e tyre për pasoja, me bërjen e rekomandimeve të duhura. Përshkrimi i fushëveprimit, rolt dhe funksionimit të auditimit të brendshëm.
- ❖ Identifikimi dhe përshkrimi i punës dhe dëshmimeve të fituara nga auditori dhe të tjerët që kërkohen për të përmbushur objektivat e angazhimeve të auditimit dhe zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)
- ❖ Shpjegimi se si shqyrtimi i ngjarjeve të mëvonshme dhe parimi i vazhdueshëm i aktivitetit mund të informojnë konkluzionet nga puna e auditimit dhe pasqyrohen në lloje të ndryshme të raportit të auditorit, përfaqësimeve me shkrim dhe rishikimit dhe raportit përfundimtar.

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Korniza e auditimit dhe rregullorja
- ❖ Auditimi i brendshëm
- ❖ Planifikimi dhe vlerësimi i riskut
- ❖ Kontrolli i brendshëm
- ❖ Të dhënat e auditimit
- ❖ Rishikimi
- ❖ Raportimi



Karakteristikat e Ligjërës Trajnuese:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Auditimi dhe Siguri-dhënia F8 - gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërë, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

KC-F9 Menaxhimi Financiar

15 Kredi

Objektivat

Objektiv kryesor është zhvillimi i njohurive dhe aftësive të pritura nga një menaxher financiar, ndërlidhje me investimet, financat dhe vendimet për politiken e dividendit.

Objektivat e detajuara:

- ❖ Sqarimi i rolit dhe qëllimit të funksionit të menaxhimit financiar
- ❖ Vlerësimi dhe diskutimi i ndikimit të mjedisit ekonomik ndaj menaxhimit financiar
- ❖ Diskutimi dhe aplikimi i teknikave të menaxhimit të kapitalit punues
- ❖ Vlerësimi efikas i investimeve
- ❖ Identifikimi dhe vlerësimi i burimeve alternative të financave të biznesit
- ❖ Sqarimi dhe kalkulimi i kostos së kapitalit dhe faktorët që kanë ndikim mbi atë
- ❖ Diskutimi dhe aplikimi i parimeve të biznesit dhe vlerësimi i pasurive
- ❖ Sqarimi dhe aplikimi i teknikave të menaxhimit të riskut

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Funksioni i menaxhimit financiar,
- ❖ Menaxhimi i kapitalit punues,
- ❖ Vlerësimi i investimeve,
- ❖ Financat e biznesit,
- ❖ Kostoja e kapitalit,
- ❖ Menaxhimi i rrezikut,
- ❖ Vlerësimet e biznesit.



Karakteristikat e Ligjërës Trajnues:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Menaxhimi Financiar F9 - gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërëse, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.